

## Aktivitetet kryesore:

- Zhvillohet trajnimi i grupit të tretë NSPK-ve të DVP Vlorë dhe të 2 grupeve të DVP Gjirokastrë.
- Mbahen mbledhjet e radhës të MKR-ve të Bashkisë Kukës dhe Gramsh
- Aktivitete të shoqatës GO2 në kuadër të projektit "I sigurt për në shkollë".
- Seminar: "Fuqizimi i partneritetit Polici – Komunitet".
- Vazhdojnë trajnimet në vendin e punës të sektorit të analizës strategjike të komisarariatit të Elbasanit .

www.cp-project.al  
info@cp-project.al

## Zhvillohen trajnimet e grupit të 3-të NSPK ve të DVP Vlorë dhe të 2 grupeve të DVP Gjirokastrë.



Në vijim të trajnimeve të NSPK-ve me qëllim rritjen e aftësive profesionale për policimin në komunitet, nga datat 9-12 Prill dhe 23-26 Prill 2019, u zhvilluan trajnimet 4 ditore të NSPK-ve, respektivisht të grupit të tretë të DVP Vlorë në Sarandë dhe të dy grupeve të DVP Gjirokastrë në Gjirokastrë dhe Përmet. Në trajnim morën pjesë 18 ndihmës specialistë të Policimit në komunitet të komisarariatit të Sarandës dhe të Himarës dhe 35 NSPK të komisarariatit të Gjirokastrës. Tepelenës dhe Përmetit.



Trajnimet kishin për qëllim rritjen e aftësive profesionale për policimin në komunitet. Ekspertët e programit SCPA në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë trajtuan gjerësisht temat teorike të tilla si Policimi në Komunitet si filozofi, sistemi dhe elementet e PK etj.

Një hapësirë e konisderueshme iu dedikua trajtimit në mënyrë praktike të rolit, detyrave dhe përgjegjësi të NSPK-ve, si dhe të parandalimit në rendin publik, veprimit pro-aktiv në vend të atij reagues, bashkëpunimit të brendshëm në zonat policore si dhe bashkëpunimit me qytetarët dhe aktorët e tjerë të komunitetit etj.

Pjesëmarrësit patën rastin të shkëmbenin eksperiencat e tyre dhe i ballafaquan ato me përvojat ndërkombëtare dhe ato të rajonit.



Ata e vlerësuan angazhimin, si dhe metodologjinë e përdorur dhe shprehën dëshirën për të pasur trajnime të ngjashme në të ardhmen.

---

## Mbahen mbledhjet e radhës të MKR-ve të Bashkisë Kukës dhe Gramsh.

Në datat 10 dhe 17 Prill 2019 u mbajtën mbledhjet e radhës të ekipeve teknike ndërdisiplinore të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit ( MKR) në Bashkitë Gramsh dhe Kukës. Në këto aktivitete morën pjesë përfaqësues të institucioneve vendore, pjesë e mekanizmit të referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Gjatë takimit u diskutuan rastet e dhunës në familje të referuara gjatë dy muajve të fundit. Çdo anëtar i ekipit me cilësinë e përfaqësuesit të institucionit përkatës mori përsipër shërbime mbështetëse dhe përgjegjësi konkrete për menaxhimin dhe integrimin e rasteve. Takimet u organizuan dhe u moderuan nga organizatat "Instituti Shqiptar për Inovacion Social" në Kukës dhe Forumi i Gruas në Elbasan, në kuadër të projektit të skemës së granteve".



---

## Aktivitetet e shoqatës GO2 në kuadër të projektit "I sigurt për në shkollë"



Në kuadër të projektit "I sigurt për në shkollë" gjatë muajit Prill 2019, shoqata GO2 organizoi vizita me nxënës të klasave të 6-ta të shkollës "Vasil Shanto" dhe "Drita Pellingu" pranë qendrës së kontrollit të trafikut të Bashkisë Tiranë.

Ekspertë të fushës pranë kësaj qendre shpjeguan në monitorë sesi vrojtohen kryqëzimet 24 orë, si menaxhohen ato nga programet soft me qëllim lehtësimin e trafikut në rrugë kryesisht në orët e ngarkuara të ditës.

Projekti ofron konceptet e sigurisë në rrugë përmes organizimit të lojërave zbavitëse për përmirësimin e qëndrimit dhe sjelljes nga pikëpamja e sigurisë rrugore me moshat e vogla shkollore.



---

## Seminar: “Fuqizimi i partneritetit Polici - Komunitet”.



Në kuadër të projektit “Fuqizimi i partneritetit Polici – Komunitet kundër DHF dhe DHBGJ në Bashkinë Kamëz” që po zbatohet nga Qendra për Zhvillim dhe Iniciativa Sociale, në 16 Prill u organizua në bashkëpunim me Bashkinë Kamëz një seminar në lidhje me masat dhe paketat legjislative të miratuara gjatë kohëve të fundit në lidhje me çështjet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Në takim morën pjesë përfaqësues nga Agjensia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, përfaqësues të Bashkisë dhe Komisarariatit të Policisë Kamëz, psikologë dhe staf social nga shkollat e mesme, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në këtë zonë.



---

## Vazhdojnë trajnimet në vendin e punës të oficerëve të Sektorit të Analizës Strategjike, Monitorimit, Planifikimit dhe Vlerësimit në Komisariatin e Elbasanit.

Në vijim të trajnimeve të vazhdueshme të sektorit të ri të analizës strategjike, monitorimit, planifikimit dhe vlerësimit (AMPV), ekspertët e EMP-së, gjatë muajit Prill kanë vazhduar trajnimet në vendin e punës të specialisteve të këtij sektori për DVP Elbasanit.

Ekspertët e SCPA-së kanë trajtuar fazën e dyte të Modulit 4 të planit të trajnimeve për këtë sektor, cili konsiston kryesisht në metodat e menaxhimit të riskut dhe përpunimin e raporteve dhe planeve të punës apo dokumenteve të ngjashme, duke i kushtuar vëmendjeje dhe kësaj metode të rëndësishme për punën e policisë.

---